

Më shumë zgjedhje përmes politikave miqësore për familjen

Raport Analitik për Kosovën

David JJ Ryan



1.1 Konteksti dhe pasqyra e përgjithshme

- Direktiva mbi balancin punë-jetë për prindërit dhe kujdestarët
(2019/1158) (“Direktiva mbi balancin punë-jetë” ose “BPJ”)
- Ka për qëllim të adresojë përfaqësimin e pamjaftueshëm të grave në tregun e punës duke:
 - mundësuar prindërve dhe kujdestarëve të arrijnë balancën më të shëndetshme midis jetës së tyre profesionale dhe atë private, dhe
 - inkurajuar balancën më të mirë në aspektin e përgjegjësi të kujdesit midis grave dhe burrave.




1.2 Konteksti dhe pasqyra e përgjithshme

- Dispozitat kryesore :
 - pushimi i atësisë (Neni. 4),
 - pushimi prindëror (Neni. 5),
 - pushimi për kujdestarët (Neni. 6), dhe
 - aranzhime fleksibile të punës (Neni. 9).
- Shtetet “... duhet të kenë parasysh që marrja e barabartë e pushimeve të lidhura me familjen ... gjithashtu varet nga masa të tjera të përshtatshme, të tilla si ofrimi i shërbimeve të arritshme dhe të përballueshme për kujdesin ndaj fëmijëve dhe shërbimet e kujdesit afatgjatë”. (BPJ, Recitali 12)



2. Koha e pushimit për prindërit

Pushimi i atësisë	Pushimi nga puna për baballarët ose prindërit e dytë të barabartë me rastin e lindjes së fëmijes me qëllim të ofrimit të kujdesit.	Direktiva e Balancit Punë-Jetë
Pushimi i lehonisë	Pushimi nga puna për <u>nënat</u> me rastin e lindjes së fëmijes me qëllim të ofrimit të kujdesit.	Direktiva për Punëtoret Shtatzëna (92/85/EEC)
Pushimi prindëror	Pushimi nga puna për të gjithë <u>prindërit</u> i cili merret pas pushimit të atësisë ose të lehonisë.	Direktiva e Balancit Punë-Jetë



3. Pushimi i atësisë (Neni 4)

Direktiva mbi balancin punë-jetë

- Së paku 10 ditë pune pushim.
- Duhet të lidhet qartë me lindjen e fëmijës.
- Paguhet të paktën në nivelin e pagesës në raste të sëmundjeve.
- Merr parasysh vënien e tij në dispozicion edhe në rastet e lindjes së fëmijës së vdekur (WLB, Recital 19)

Kosova

- 2 ose 3 ditë pune, të paguara plotësisht.

(Ligji i Punës, Neni 50.2.1 dhe 39.1.3)

dhe

- 10 ditë pune, pa pagesë, deri sa fëmija të mbushë 3 vjeç.
(Ligji i Punës, Neni 50.2.2)
- Pushimi i lehonisë në dispozicion në rast të lindjes së fëmijës së vdekur ose abortit. (Ligji i Punës, Neni. 51.1)


4.1 Pushimi prindëror (Neni. 5)

Direktiva mbi balancin punë-jetë

- 4 muaj, e drejtë individuale e të dy prindërve.
- Së paku 2 muaj i patransferueshëm.
- Merret para se fëmija të arrijë një moshë të caktuar (maks. 8).
- Mund të merret në mënyra fleksibile.

Kosovë

- Asnjë e drejtë krahasuese.
- Disa pushime të lehonisë të transferueshme.
(Ligji i Punës, Neni. 49.7-49.8 dhe 50.1)
- Pushime vjetore shtesë për nënat dhe prindërit vetëushqyes me fëmijë deri në moshën 3 vjeç.
(Ligji i Punës, Neni. 32.4)




4.1 Pushimi Prindëror (Neni. 5)

Direktiva mbi balancin punë-jetë

- 4 muaj, e drejtë individuale e të dy prindërve.
- ~~Së paku 2 muaj~~ Tërësisht i patransferueshëm.
- Merret para se fëmija të mbush 12 vjet ~~moshë e caktuar (max. 8).~~
- Mund të merret në mënyra fleksibile.


Kosovë

- Asnjë e drejtë krahasuese.
- Disa pushime të lehonisë të transferueshme.
(Ligji i Punës, Neni. 49.7-49.8 dhe 50.1)
- Pushime vjetore shtesë për nënat dhe prindërit vetëushqyes me fëmijë deri në moshën 3 vjeç.
(Ligji i Punës, Neni. 32.4)




4.2 Kompensimi

- Kompensimi i pushimit prindëror “... do të vendoset në mënyrë të tillë që të lehtësojë shfrytëzimin e pushimit prindëror nga të dy prindërit.” (BPJ, Neni. 8.3)
- Shtetet që ofrojnë “... një normë relativisht të lartë të zëvendësimit [të pagave] përjetojnë një normë më të lartë të marrjes së të drejtës nga baballarët dhe një trend pozitiv në shkallën e punësimit të nënave.” (BPJ, Recital 26)
- Zëvendësimi minimal i pagës prej 67% është i nevojshëm edhe për shfrytëzimin modest të pushimit të atësisë, ndërsa 80-100% nevojitet për të arritur shfrytëzimin nga një shumicë e konsiderueshme e burrave. (OECD, 2017)
- Kalimi drejt një modeli financiar kolektiv (p.sh. kontributet e sigurimit dhe/ose taksat) mund të sigurojë shpërndarje më të drejtë dhe më të qëndrueshme të kostove për të gjitha format e pushimit familjar.




5.1 Vlerësimi i nevojave të ndryshme të familjeve

- Pushimi i atësisë duhet të shtrihet tek **"prindërit e dytë ekuivalentë"**. (BPJ, Neni 4.1)
- Pushimi prindëror mund të shtrihet në **"të gjithë punonjësit që ushtrojnë përgjegjësi prindërore"**. (BPJ, Recital 21)
- Të merren parasysh:
 - familjet e riformuara,
 - familjet me një prind, dhe
 - çiftet e të njëjtit seks.



5.2 Vlerësimi i nevojave të ndryshme të familjeve

- Konsideroni nëse nevojiten përshtatje për:
 - prindërit birësues,
 - prindërit me aftësi të kufizuara,
 - prindërit me fëmijë me aftësi të kufizuara ose sëmundje afatgjatë, dhe
 - punëtorë të vetëpunësuar.
(Direktiva për vetëpunësim 2010/41/BE)




6. Pushimi i kujdestarëve (Neni. 6)

- “... pushimi nga puna për punëtorët në mënyrë që të sigurojnë kujdes ose mbështetje personale për një të afërm, ose një personi që jeton në të njëjtën familje me punëtorin, dhe i cili ka nevojë për kujdes ose mbështetje të rëndësishme për një arsye serioze mjekësore”. (BPJ, Neni. 3.1(c))
- Minimumi 5 ditë të punës. (BPJ, Neni. 6.1)
- Konsiderohet rritja e pushimit në 12 ditë pune dhe ofrimi i fleksibilitetit. (BPJ, 2019)
- Shtetet “...inkurajohen që të aplikojnë një pagesë të tillë ose një kompensim për të garantuar marrjen efektive të së drejtës nga kujdestarët, posaçërisht nga burrat.” (BPJ, Recital 32)




7.1 Rregullimi i orarit fleksibil të punës (Neni. 9)

- “... mundësia që punëtorët të rregullojnë modelet e tyre të punës, duke përfshirë përdorimin e aranzhimit të punës në distancë, oraret fleksibël të punës ose oraret e reduktuara të punës. ” (BPJ, Neni. 3.1(f))
- Kufizuar më parë në kthimin nga pushimi prindëror. (Direktiva e Pushimit Prindëror 2010/18/BE, Klauzola 6.1)
- Dispozita e re:
 - shtrin të drejtën për kujdestarët dhe të gjithë punëtorët me fëmijë deri në një moshë të caktuar (maks. 8), por
 - është një e drejtë vetëm që bëhet me kërkesë, jo e drejtë automatike.



7.2 Rregullimi i orarit fleksibil të punës (Neni. 9)

- Dizajni nuk duhet të jetë tepër përshkrues.
- Për bizneset:
 - format e aranzhimeve përfundimisht do të varen nga karakteristikat e organizatës ose sektorit më të gjerë, dhe
 - zhvillimi i aranzhimeve do të kërkojë të menduarit kreativ për modelet ekzistuese të organizimit të punës dhe praktikës menaxheriale. (OECD, 2016)
- Të shmanget tejtheksimi i punës me kohë të pjesshme. (BPJ, Recital 35)



7.3 Rregullimi i orarit fleksibil të punës (Neni. 9)

Korniza aktuale në Kosovë është e kufizuar.

“... punëdhënësit janë të detyruar të marrin të gjitha masat e nevojshme për t'u mundësuar grave dhe burrave që të korrespondojnë me detyrimet e tyre profesionale dhe familjare”. (Ligji për Barazinë Gjinore, Neni. 17.1.15)


- Një prind i një fëmije me kërkesa të veçanta të kujdesit shëndetësor mund të punojë me kohë të pjesshme derisa fëmija të mbushë 2 vjeç. (Ligji i Punës, Neni. 52.1)
- Disa punonjës nuk janë të detyruar të punojnë me ndërrime nate ose jashtë orarit (p.sh. gratë shtatzëna, nënat ose prindërit e vetëm me fëmijë nën 3 vjeç, etj.). (Ligji i Punës, Neni. 48)



7.4 Rregullimi i orarit fleksibil të punës (Neni. 9)

Rekomandimet

- Të sigurohet e drejta për të kërkuar orare fleksibile pune për :
 - kujdestarët për qëllime të kujdesit, dhe
 - të gjithë prindërit me fëmijë nën 12 vjeç.
- Të zgjerohet mbrojtja shtesë për prindërit me fëmijë me nevoja të veçanta të kujdesit
- Të transformohen të drejtat specifike gjinore në ato neutrale gjinore.
- Të konsiderohet mundësia e sigurimit alternativ të të drejtave për të gjithë punëtorët



8. Përmbledhje

- Të rritet numri i ditëve të **pushimit të atësisë** (min. 10 ditë).
- Të mundësohet **pushimi prindëror** për të gjithë prindërit (min. 4 muaj).
- Të sigurohen normat e larta të zëvendësimit të pagave për të arritur shfrytëzimin e pushimit nga burrat.
- Të merret parasysh **financimi i pushimeve që lidhen** me familjen përmes një skeme të financimit kolektiv për të siguruar shpërndarje më të drejtë të kostove.
- Të zgjerohen të **drejtat e barabarta** tek të gjitha llojet e familjeve.
- Të futet e drejta për **pushimin e kujdestarit** (min. 5 ditë).
- Të krijohen **aranzhime fleksibile të punës** për prindërit dhe kujdestarët.



FALEMINDERIT!

